

V E N D I M
Nr.346, datë 8.1.1996

**PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE NË
MIRËMBAJTJEN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL E URBAN
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nga fondet buxhetore të caktuara nga buxheti i shtetit për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor, të bëhet prokurimi dhe kontraktimi me sipërmarrës privatë për shërbimet e mëposhtme:
 - riparime, përmirësime e riveshje të shtresave rrugore;
 - pastrime dhe evadime të materialeve të ndryshme shkëmbore e argjilore etj.;
 - riparime të veprave të artit;
 - transporte të materialeve që shërbejnë për mirëmbajtjen dimërore (skorje etj.), si dhe materiale ndërtimore që shoqërojnë kontraktimet e mësipërme.
 2. Procedurat e dhënies me sipërmarrje të këtyre punimeve të kryhen sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet.
 3. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Sekretariati Shtetëror i Pushtetit Lokal të organizojë prokurimet e mësipërme nëpërmjet njësive të tyre administrative.
 4. Ngarkohet Ministria e Ndërtimit dhe Turizmit, në bashkëpunim me Sekretariatën Shtetëror të Pushtetit Lokal, të nxjerrin udhëzimet e nevojshme dhe të miratojnë kontratën-tip të sipërmarrjes.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi